

## Vendim nr. 26 datë 03.02.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 03.02.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 31 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ERVEREST MUÇO, përfaqësuar nga avokate Anilda Sefgjini me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2762 (264), datë 27.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, 42, 49/1, 107/3, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 28, 45, pika 1, 45, 47, 49/3/e, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka punuar fillimisht në pozicionin “specialist” në Sektorin e Trajnimit dhe *Help-Deskut* në Drejtorinë e Dokumenteve të Identitetit dhe Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme. Me shkresën nr. 228/2, datë 22.02.2012, Departamenti i Administratës Publike (*DAP*) ka miratuar vendimin për

konfirmimin e statusit të nëpunësit civil për kërkuesin në atë pozicion pune. Pas ristrukturimit të institucionit ai është emëruar në pozicionin “specialist” në Drejtorinë e Hartimit dhe Monitorimit të Standardeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektimit, Çështjeve të Sigurisë dhe Standardeve, në Ministrinë e Brendshme.

2. Ndërkohë, në datën 30.05.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (*ligji nr. 152/2013*), i cili është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8215, datë 04.06.2013. Në nenin 72 të ligjit nr. 152/2013 parashikohej data 01.10.2013 si momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sipas nenit 70 të ligjit nr. 152/2013, hyrja në fuqi e ligjit të ri sillte si pasojë shfuqizimin e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (*ligji nr. 8549/1999*) dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me të.

3. Në vijim, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”” (*akti normativ*), i cili ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.159, datë 30.09.2013. Miratimi i aktit normativ ka sjellë ndryshimin e neneve 70 dhe 72 të ligjit nr. 152/2013, sipas të cilave tashmë parashikohej se ligji nr.8549/1999 dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohej nga data e fillimit të shtrirjes së efekteve të ligjit nr. 152/2013, i cili hynte në fuqi në datën 01.10.2013 dhe i fillonte efektet e tij 6 muaj pas hyrjes në fuqi, ndërkohë që deri në datën e fillimit të efekteve të këtij ligji zbatohet ligji nr. 8549/1999. Në vijim, Kuvendi ka miratuar aktin normativ me ligjin nr.161/2013 “Për miratimin e aktit normativ nr.5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”” (*ligji nr. 161/2013*).

4. Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014, (*vendimi nr. 5/2014*), ka vendosur shfuqizimin e aktit normativ nr.5/2013 dhe ligjit nr.161/2013, si të papajtueshme me Kushtetutën. Vendimi nr. 5/2014 i Gjykatës është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 26.02.2014 dhe ka hyrë në fuqi po në atë datë.

5. Në vitin 2013 Ministria e Brendshme i është nënshtruar sërish ristrukturimit. Në vijim, me vendimin nr. 7784, datë 11.11.2013 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme (*vendimi nr.7784/2013*) është vendosur kalimi i kërkuesit në listëpritje, për shkak të ristrukturimit dhe shkurtimit të vendit të punës. Sipas këtij vendimi, kërkuesit i fillonin marrëdhëniet financiare në listën e pritjes në datën 15.11.2013. Në datën 08.01.2014 kërkuesi i është drejtuar DAP-it, duke kërkuar rikthimin e tij në Shërbimin Civil në një nga pozicionet “specialist” të shpallura vakante nga ana e këtij institucioni.

6. Më tej, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, DAP-it, për ta emëruar nga lista e

pritjes në një nga vendet vakante të shpallura në faqen zyrtare të këtij institucioni, si dhe detyrimin e DAP-it të paguante kërkuesin nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në momentin e emërimit të tij në Shërbimin Civil. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2177, datë 07.05.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit.

7. Në datën 10.06.2014, duke mos qenë dakord me kalimin e tij në listë pritje, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të shkresës nr. 7784 prot., datë 04.11.2013 “Vendim për kalimin në listë pritjeje” të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, rikthimin në punë në një pozicion të së njëjtës kategori dhe vazhdimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare e deri në rikthimin e tij në punë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të shkresës nr. 1536/1 prot., datë 04.11.2013 të DAP-it, si dhe detyrimin për nxjerrjen e aktit të emërimit në pozicionin “specialist”, në strukturën e re të Ministrisë së Brendshme ose në një tjetër institucion në Shërbimin Civil.

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5188, datë 29.09.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit, me arsyetimin se ajo ishte paraqitur tej afatit ligjor. Sipas gjykatës së shkallës së parë, palët duhet të kishin paraqitur ankim në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC) brenda afatit të parashikuar në ligjin nr. 8549/1999 për konflikte të lindura përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013. Në këtë kuptim, që nga momenti që kërkuesi ka marrë dijeni për vendimin nr. 7787/2013 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme për kalimin e tij në listën e pritjes, ai duhej t’i ishte drejtuar KSHC-së. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar KSHC-së në datën 01.11.2013, përpara se të vendosej kalimi i tij në listën e pritjes dhe nuk rezultonte që KSHC-ja të ishte shprehur në lidhje me këtë kërkesë të tij. Nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013 kërkuesi kishte 60 ditë kohë që t’i drejtohej gjykatës me padi kundër vendimit nr. 7787/2013 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, ndërkohë kërkesëpadija e tij është paraqitur në gjykatë në datën 10.06.2014. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1626, datë 14.04.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit në drejtim të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 7784/2013 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme për kalimin e tij në listë pritje; detyrimin të palës së paditur, Ministrisë së Brendshme, për ta rikthyer kërkuesin në vendin e mëparshëm të punës si specialist në Drejtorinë e Hartimit dhe Monitorimit të Standardeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektimit të Çështjeve të Sigurisë së Standardeve ose për t’i ofruar atij një vend pune të të njëjtit nivel në Ministrinë e Brendshme;

detyrimin të palës së paditur Ministrisë së Brendshme t'i paguajë kërkuetit pagën deri në rikthimin në vendin e mëparshëm të punës ose deri në emërimin si nëpunës civil në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel. Ndërkohë që gjykata e apelit ka rrëzuar kërkesëpadinë për pjesën tjetër të kërtimeve të kërkuetit. Sipas gjykatës së apelit, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural, por në vlerësim të gabuar të provave dhe interpretim jo të drejtë të ligjit material. Kundër këtij vendimi, në datën 31.05.2017, ka ushtruar rekurs DAP-i dhe në datën 11.05.2017 ka ushtruar rekurs Ministria e Brendshme.

10. Më tej, Ministria e Brendshme i është drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1626, datë 14.04.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 140, datë 20.03.2018, ka vendosur mospranimin e kërkesës së Ministrisë së Brendshme.

11. Për sa u përket rekurseve të ushtruara nga DAP-i dhe Ministria e Brendshme, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2762 (264), datë 27.06.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas Kolegjit Penal, vendimi i gjykatës së apelit është marrë në interpretim të gabuar të ligjit, ndërsa nga ana e gjykatës së shkallës së parë është bërë identifikim i saktë dhe i drejtë i ligjit të zbatueshëm, në rastin konkret të ligjit nr. 8549/1999 në raport me datën 10.06.2014, në të cilën është depozituar padia në gjykatë.

12. Në datën 27.11.2027 kërkueti i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

13. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

13.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmes të cilit është vendosur mospranimi i kërkesës së Ministrisë së Brendshme për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit ka krijuar pritshmëri të ligjshme tek ai, që në procesin e themelit Gjykata e Lartë nuk do ta ndryshonte vendimin e gjykatës së apelit në disfavor të kërkuetit. Në këto kushte, ai do të ishte i sigurt dhe nuk do të jetonte me frikë se do të humbiste gjyqin apo se mund të detyrohej të kthente pagën e marrë për disa vite deri në sistemimin e tij në një vend tjetër të barasvlershëm.

13.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme në çështje të së njëjtës natyrë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

15. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

17. Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, mban datën 27.06.2024 dhe është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 01.08.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe parimit të barazisë përpara ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës.

19. Kolegji konstaton se për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit kërkuesi ka parashtruar se pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme në çështje të së njëjtës natyrë.

20. Kolegji thekson se Gjykata ka mbajtur qëndrimin se kur kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën se si gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, atëherë vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet duke verifikuar rrethanat e rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji vëren se dy vendimet e cituara nga kërkuesi nuk rezultojnë të jenë njësuere për praktikën gjyqësore ndaj ato vendime nuk përbëjnë argument të mjaftueshëm kushtetues për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se vendimet gjyqësore janë rrjedhojë e shqyrtimit të pretendimeve dhe provave të ndryshme të paraqitura prej palëve ndërgjyqëse në secilin rast, ndaj vendimmarrjet e lidhura me mosmarrëveshjet e punës të mbështetura, në dukje, në fakte të njëjta, mund të jenë të ndryshme. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se argumentet për këtë pretendim nuk janë në nivel kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim.

22. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, Kolegji vlerëson se ky pretendim *prima facie* përfshihet në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

#### *B.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*

23. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmes të cilit është vendosur mospranimi i kërkesës së Ministrisë së Brendshme për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit ka krijuar tek ai pritshmëri të ligjshme, që në procesin e themelit Gjykata e Lartë nuk do ta ndryshonte vendimin e gjykatës së apelit në disfavor të tij. Në këto kushte, kërkuesi do të ishte i sigurt dhe nuk do të jetonte me

frikë se do të humbiste gjyqin apo se mund të detyrohej të kthente pagën e marrë për disa vite deri në sistemimin e tij në një vend tjetër të barasvlershëm.

24. Gjykata ka vlerësuar se parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën kushtetuese vazhdimisht është theksuar se në parim vendimet për marrjen e masës provizore të pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv nuk mund të konsiderohen si përfundimtare për efekt të gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës. Këto lloj vendimesh nuk janë përfundimtare në lidhje me të drejtat themelore, për pasojë nuk vendosin automatikisht në lidhje me të drejta ose detyrime civile (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Duke iu kthyer çështjes objekt shqyrtimi, Kolegji vëren se Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar pjesërisht kërkesëpadinë e kërkuarit në drejtim të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 7784/2013 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme për kalimin e tij në listëpritje, si dhe detyrimit të palës së paditur, Ministrisë së Brendshme për të rikthyer kërkuarin në vendin e mëparshëm të punës ose për t'i ofruar atij një vend pune të të njëjtit nivel në të njëjtin institucion, si dhe për t'i paguar atij pagën deri në rikthimin në vendin e mëparshëm të punës ose deri në emërimin si nëpunës civil në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel.

26. Në vijim, Ministria e Brendshme i është drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me kërkesën e datës 26.02.2018, përmes së cilës ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, ku, ndër të tjera, ka parashtruar se ekzekutimi i menjëhershëm i atij vendimi do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme për këtë institucion. Bashkëlidhur kësaj kërkesë, Ministria e Brendshme ka paraqitur edhe kopje të rekursit të ushtruar nga ana e saj kundër vendimit gjyqësor, ekzekutimi i të cilit kërkohej të pezullohej. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës së Ministrisë së Brendshme, pasi ka vlerësuar se kërkimi i saj mbetet hipotetik, për sa kohë nuk ishin parashtruar argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregonin mundësinë e ardhjes së këtyre pasojave. Më tej, në lidhje me rekursin e Ministrisë së Brendshme dhe DAP-it, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka disponuar me lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit është marrë në interpretim të gabuar të ligjit.

27. Për sa më lart, Kolegji vëren se, sipas nenit 449 të Kodit të Procedurës Civile, ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e shqyrtimit në gjykatën e apelit, përveç kur me ligj parashikohet ndryshe, ndërsa në rastet e rekursit në Gjykatën e Lartë,

vendimi mund të pezullohet në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, pezullimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit përbën përjashtim nga rregulli dhe vendoset nga Gjykata e Lartë si një lloj mase paraprake, kur ekzistojnë të dhëna që ekzekutimi i vendimit rrezikon të sjellë pasoja që nuk mund të rikuperohen. Në këtë pikëpamje, Kolegji vlerëson se kur Gjykata e Lartë nuk pranon kërkesën për pezullim nuk mund të pretendohet se ajo gjykatë ka vlerësuar themelin e shkaqeve të rekursit, ndaj, si rrjedhim, ky lloj vendimi nuk krijon pritshmëri të ligjshme.

28. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.